



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.122

22 shtator

2007

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9800 datë 10.9.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” 3427
Vendim i Kuvendit nr.117, datë 23.7.2007	Për dhënien në përdorim, pa kundërshtpërblim, të një mjedisi në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit..... 3430
Vendim i Kuvendit nr.118, datë 23.7.2007	Për dhënien në përdorim, pa kundërshtpërblim, të një mjedisi në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar Agjencisë Telegrafike Shqiptare 3432
Vendim i Kuvendit nr.119, datë 10.9.2007	Për zgjedhjen e një anëtarit të Komisionit të Shërbimit Civil ... 3434

LIGJ
Nr.9800, datë 10.9.2007

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.9643, DATË 20.11.2006 “PËR
PROKURIMIN PUBLIK”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

- a) në pikën 2, pas fjalëve “janë kontratat për shërbime” shtohet fjala “publike”;
- b) pika 2 bëhet pika 3;
- c) pika 3 bëhet pika 2;
- ç) në pikën 20 rreshti i parë hiqen fjalët “me negocim dhe pa njoftim publik”.

Neni 2

Në nenin 9 rreshti i dytë parafjala “për” zëvendësohet me parafjalën “me”.

Neni 3

Në nenin 12 pika 5 fjalia e dytë, pas fjalës “mbështetje” shtohen fjalët “në formën e këshillave dhe të udhëzimeve”.

Neni 4

Në nenin 13 pika 2, pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:
“l) kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me ligj.”

Neni 5

Në nenin 19 pika 2 rreshti i parë fjala “pagat” hiqet.

Neni 6

Në nenin 21 pika 2 shkronja “c” fjala “të pasuksesshëm” zëvendësohet me fjalën “të suksesshëm”.

Neni 7

Në nenin 29 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) në fund të pikës 4 shtohen fjalët “sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj”;
- b) në pikën 5 fjala “blerjet” zëvendësohet me fjalën “prokurimet”.

Neni 8

Në nenin 33 bëhen këto ndryshime:

a) në pikën 1 rreshti i parë, pas fjalëve “me vlerë mbi” shtohen fjalët “ose nën”;

b) në pikën 2 shkronja “c” riformulohet si më poshtë:

“c) kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit.”.

Neni 9

Në nenin 34 pika 1 fjalia e tretë fjalët “kërkohen të paktën 5 oferta” zëvendësohen me fjalët “kërkohet të ftohen të paktën 5 operatorë ekonomikë”.

Neni 10

Në nenin 38 pika 1 riformulohet si më poshtë:

“1. Autoriteti kontraktor, që kryen procedura prokurimi për kontrata publike me anë të procedurës së hapur, të kufizuar, me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit ose kërkesës për propozim, në përputhje me nenet 30, 31, 32 e 34 të këtij ligji, ose kur fillon procedurën konkurs projektimi, sipas nenit 35 të ligjit, bën njoftimin publik për kryerjen e llojit përkatës të prokurimit publik.”.

Neni 11

Në nenin 42 pika 1 fjalia e parafundit riformulohet si më poshtë:

“Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor e zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”.

Neni 12

Në nenin 43 bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) në pikën 3, pas fjalëve “me shpallje të njoftimit” shtohen fjalët “me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar”;

b) në pikën 6 shkronja “b” fjalët “është botuar njoftimi i kontratës”, zëvendësohen me fjalët “është dërguar te kandidatët ftesa për ofertë.”.

Neni 13

Në nenin 45 pika 1, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) falsifikim.”.

Neni 14

Në nenin 48 pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Autoriteti kontraktor, kur jep sqarime ose bën ndryshime në dokumentet e tenderit, vepron në përputhje me nenin 42 të këtij ligji.”.

Neni 15

Në nenin 52 pika 5 hiqen fjalët “dhe i vlerësimit të”.

Neni 16

Në nenin 64 pika 2 rreshti i dytë, pas fjalëve “dhe para lidhjes së kontratës” shtohen fjalët “kur nuk vendos pezullimin”.

Neni 17

Pas nenit 75 shtohet neni 75/1 si më poshtë:

“Neni 75/1

Dispozitë e veçantë

1. Procedurat e nisura në përputhje me ligjin nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, përfshirë edhe ankimin, trajtohen sipas ligjit nr.7971.

2. Shkronja “ç” e pikës 3 të nenit 13 zbatohet edhe në rastin e kontratave të nënshkruara para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Pikat 2 shkronja “a” dhe 5 të nenit 33 zbatohen edhe për kontratat e lidhura pas përfundimit të procedurave të prokurimit, në bazë të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, edhe kur kjo nuk është parashikuar në kontratën fillestare.”.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5460, datë 14.9.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM

Nr.117, datë 23.7.2007

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, TË NJË MJEDISI NË PRONËSI TË RADIO TELEVISIONIT PUBLIK SHQIPTAR KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT

Në mbështetje të neneve 2 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 7, 64 dhe 147 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, vendimit nr.440, datë 1.6.2000 të Kuvendit "Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)" dhe të neneve 11 dhe 12 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pas dhënies/marrjes së pëlqimit paraprak të Këshillit Drejtues të RTSH-së,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien në përdorim, pa kundërshtëpërbllim, të mjediseve të godinës në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë për një afat të pacaktuar.

II. Në kontabilitetin e RTSH-së të pasqyrohet dhënia në përdorim, pa kundërshtëpërbllim, pa afat të caktuar, e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi.

III. Shpenzimet që do të kryhen për rikonstruksionin e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi, të përballohen në emër dhe për llogari të Buxhetit të Shtetit. Ato janë të pakompensueshme nga Radio Televizionit Publik Shqiptar.

IV. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Publik Shqiptar dhe Kryetari i Këshilli Kombëtar të Radios dhe Televizionit për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)



VENDIM
Nr.118, datë 23.7.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, TË NJË MJEDISI NË
PRONËSI TË RADIO TELEVISIONIT PUBLIK SHQIPTAR AGJENCISË TELEGRAFIKE
SHQIPTARE**

Në mbështetje të neneve 2 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 7, 64 dhe 147 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.440, datë 1.6.2000 të Kuvendit “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)” dhe të neneve 11 dhe 12 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pas dhënies/marrjes së pëlqimit paraprak të Këshillit Drejtues të RTSH-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënie në përdorim, pa kundërshtpërblim, të mjediseve të godinës në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, Agjencisë Telegrafike Shqiptare, si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë për një afat të pacaktuar.


II. Në kontabilitetin e RTSH-së të pasqyrohet dhënia në përdorim, pa kundërshtpërblim, pa afat të caktuar, e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi.

III. Shpenzimet që do të kryhen për rikonstruksionin e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi, të përballohen në emër dhe për llogari të Buxhetit të Shtetit. Ato janë të pakompensueshme nga Radio Televizionit Publik Shqiptar.

IV. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Publik Shqiptar dhe Drejtori i Agjencisë Telegrafike Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)



VENDIM
Nr.119, datë 10.9.2007

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË KOMISIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, me propozimin e përfaqësuesve të mbledhjes së pushtetit vendor,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Vera Shtjefni zgjidhet në detyrën e anëtares së Komisionit të Shërbimit Civil, në vend të zonjës Liri Jani, së cilës i ka mbaruar mandati.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME**

BOTIME TË REJA *(Të përditësuara gusht 2007)*

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat
- Kodi i familjes (përfshirë legjislacioni për birësimet)

Hyri në shtyp më 20.9.2007
Doli nga shtypi më 22.9.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 12 lekë